

TË HUMBASËSH QËLLIMIN E JETËS

Shumë njerëz sot besojnë se teoria e Darvinit rreth origjinës së njeriut është e saktë dhe e besueshme. Nëse do të gjendeni në një klasë ku mësohet se si arritëm te njeriu i sotëm, sipas teorisë së Darvinit, ndoshta mësuesi do t'ju tregojë disa vizatime që, sipas kësaj teorie, paraqesin fazat e ndryshme të zhvillimit të njeriut nga majmuni. Këto vizatime, që s'janë gjë tjetër veçse produkt i imagjinatës së një piktori, zakonisht paraqesin një numër krijesash të kërrusura me tipare shtazarake dhe të frikshme. Madje edhe emrat që u janë vënë këtyre krijesave majmun-njeri nga «shkenca» janë impresionuese për dikë që fillon të studiojë «origjinën» e njeriut dhe të gjithësisë. Në fund të fundit, si do të reagoje ndaj emrave të tillë si *Australopithecus* dhe *Hesperopithecus Haroldcookii*? Janë pikërisht këto lloj zbulimesh që përdoren si themel për teorinë e evolucionit. Miliona njerëz kanë qenë të detyruar ta studiojnë këtë teori në shkollë. Për më tepër, kjo teori e gabuar vazhdon t'u mësohet miliona fëmijëve sot, në mbarë botën.

Disa, ndoshta, nuk shikojnë ndonjë lidhje midis teorisë së evolucionit dhe ateizmit, por të dyja këto janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në fakt, ato varen nga njëra-tjetra në mënyrë të ndërsjellë. Njëra nuk mund të bëjë pa tjetrën! Pse themi se ateizmi varet nga teoria e evolucionit? Përgjigjja gjendet në çështjen e «origjinës». Për të shpjeguar origjinën e jetës, ne duhet të pranojmë ose ekzistencën e Perëndisë ose teorinë e evolucionit. Dhe, kur ateisti

e mohon Perëndinë, nuk i mbetet zgjidhje tjetër veçse të pranojë teorinë e evolucionit, por thjesht kjo zgjidhje e dytë tregon dështimin e ateizmit.

Shikoni se si teoria e evolucionit bën që njeriu të humbasë tërësisht qëllimin e jetës.

KONTRADIKTAT BRENDA TEORISË SË EVOLUCIONIT

Teoria e evolucionit është në kontradiktë me ligjet themelore të fizikës. Ligji i Parë i Termodinamikës thotë se proceset natyrore nuk krijojnë diçka duke u nisur nga asgjëja. Në anën tjetër, teoria e evolucionit mbron tezën se kohë më parë asgjë nuk ekzistonte dhe papritur kjo «asgjë» prodhoi diçka. Shkenca sot thotë se universi filloi nga asgjëja. Pra, teoria e evolucionit bie ndesh me këtë ligj themelor të fizikës. «*Ligji i dytë i ri i përgjithshëm i termodinamikës*» gjithashtu tregon të meta dhe gabime të tjera të teorisë së evolucionit. Ligji thotë se, nëse ky univers do të kishte qenë këtu përherë, tani ai do të ishte në një gjendje «pushimi», sepse proceset e ndërlikuara dhe komplekse (të tilla janë proceset e natyrës rreth nesh) gjithmonë shpërbëhen (thjeshtëzohen). Proceset natyrore zhvillohen gjithmonë në përputhje me ligjet e sakta të natyrës, ato *kurrë* nuk fillojnë nga më e thjeshta për të arritur te më e ndërlikuara! Kështu që, kur teoria e evolucionit thotë se natyra (materia) ka aftësinë të bëjë «mrekulli», d.m.th. që forma të caktuara mund të zhvillohen nga një stad më i thjeshtë në një stad më

të ndërlikuar, ajo bie në kontradiktë me këto ligje të natyrës. Kështu, ajo bie në kontradiktë me ligjet e shkencës së vërtetë.

Teoria e evolucionit bie në kundërshtim edhe me logjikën elementare. Edhe pasi gjithçka është studiuar, prapë teoria e evolucionit nuk jep ndonjë shpjegim shkencor dhe logjik për origjinën e universit dhe njeriut. Përpyekjet për të shpjeguar këtë origjinë duke u bazuar në teorinë e evolucionit kanë qenë të kota. Le të sjellim një shembull, midis shumë të tjerëve, që tregon falsitetin e kësaj teorie. F.H.C. Crick, zbuluesi i molekulës së DNA, ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të shkencës së gjenetikës dhe të biologjisë. Ai besonte në teorinë e evolucionit. Ai hodhi idenë se jeta filloi kur një formë bakterie u dërgua në tokë me anë të një rakete nga ndonjë pjesë tjetër e hapësirës!

Teoria e evolucionit bie ndesh me faktet themelore të shkencës së vërtetë. Shumë fakte shkencore paraqiten nga mbështetësit e teorisë së evolucionit të shtrembëruara. Të ashtuquajturit «ekspertë» dëshmojnë për vërtetësinë e teorisë së evolucionit. Në funksion të kësaj ata paraqesin shumë «fakte» për të justifikuar teorinë e tyre, por le të mbajmë në mendje se një «ekspert» është thjesht një njeri që bie dakord me një pikëpamje të caktuar. Gjithashtu, «faktet» e përdorura shpesh nuk janë gjë tjetër veçse hipoteza, vërtetësia e të cilave nuk është provuar.

TË BESOSH NË TEORINË E EVOLUCIONIT ËSHTË TRAGJIKE

Tragjedia më e madhe e teorisë së evolucionit është përfundimi i saj që njerëzit janë thjesht kafshë që zotërojnë një nivel më të lartë ndërgjegjeje dhe aktiviteti. Por disa vëzhgime të thjeshta dhe praktike tregojnë se kjo nuk është e vërtetë! Po të krahasojmë njeriun me majmunin, do të vërejmë ndryshime të mëdha. Jeta e njeriut dhe ajo e majmunit ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Gjatë vdekjes «e kuptojmë» se një ndryshim ekziston midis njeriut dhe kafshës.

Ndryshimet midis njeriut dhe majmunit ngrenë një sërë pyetjesh serioze të cilat shqetësojnë ndjekësit e teorisë së evolucionit. Pse ka kaq shumë ndryshime thelbësore *në qoftë se* njeriu është një kafshë si edhe majmuni? A nënkuptojnë këto ndryshime se njeriu do të ketë një destinacion tjetër, të ndryshëm nga ai i majmunit? A mundet që ky destinacion të përfshijë «përjetësinë»? Çfarë cilësie

i jep njeriut mundësinë që të mposhtë madje edhe kafshën më të fuqishme? Çfarë e bën jetën e një njeriu «njerëzore» dhe të një kafshe «shtazore»?

Besimi në teorinë e evolucionit ka pasoja tragjike. Këto pasoja janë bërë shumë të dukshme në shekullin tonë, ku imoraliteti dhe padrejtësia duket sikur kanë mposhtur civilizimin. E keqja dhe imoraliteti mbizotërojnë sot në botë, sepse jeta njerëzore e ka humbur «njerzillëkun» e saj dhe, në këtë mënyrë, duket se e ka humbur kuptimin dhe vlerën e saj!

PASOJAT E TEORISË SË EVOLUCIONIT

Teoria e evolucionit është përdorur si prova e filozofisë e ateiste. Kjo teori po vazhdon të përhapet me ndihmën e «intelektualëve» të shekullit tonë. Kjo teori shpërfill fjalët e frymëzuara të Psalmit 8.

Ne lexojmë te Psalmi 8 për lavdinë e Perëndisë dhe për dinjitetin që Perëndia i ka dhënë njeriut (shikoni vargjet 5–6). Këto janë dy fakte të cilat teoria e evolucionit i ka fshirë nga mendjet e shumë njerëzve sot. Bibla tregon se dinjiteti i njeriut në mënyrë të padiskutueshme është i lidhur me lavdinë e Perëndisë. Në qoftë se Perëndia nuk ka lavdi, atëherë njeriu nuk ka dinjitet! Psalmi e jep me shumë detaje dinjitetin e njeriut dhe i paraqet qeniet njerëzore të veshura me lavdi. Njeriu u krijua nga Perëndia dhe ka vlerë dhe dinjitet të trashëguar që nuk mund të gjenden te kafshët. Njeriu është vendosur mbi kafshët, sepse ai është shumë më ndryshe se ato!

Edhe pse teoria e evolucionit mbrohet nga «intelektualët», ajo është një teori dhe jo fakt! Ajo mohon veçantinë e njeriut, krijimin e tij nga Perëndia i Plotfuqishëm, autoritetin e tij mbi kafshët dhe krijimin e tij në përputhje me imazhin e Perëndisë! Pa besimin se shpirti i njeriut, «i krijuar sipas imazhit të Perëndisë» (Zanafilla 1:26), e vë atë më lart se kafshët, njeriu humbet qëllimin e jetës së tij.

Me fjalë të tjera, teoria e evolucionit eleminon dinjitetin njerëzor, vlerën dhe cilësitë personale të njeriut. Konkluzioni i saj tragjik është thënë nga ateisti Jacques Monod: «Njeriu së paku e di se është i vetëm në universin e pafund e armiqësor, brenda të cilit ai u shfaq aksidentalisht.»

KONKLUZIONI

Ne kemi ardhur këtu në tokë ose «aksidentalisht», ose jemi këtu sipas qëllimit të Krijuesit të

fuqishëm. Në qoftë se teoria e evolucionit është e vërtetë, atëherë jeta jonë nuk ka as qëllim dhe as

kuptim. Në qoftë se ne jemi krijuar nga Perëndia, atëherë ekzistenca jonë e ka një qëllim.

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: "*Perëndia kundër ateizmit*"
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara